

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7018
E mërkurë, 11 tetor 2023
Çmimi 0.50 €

Turqia udhëheq komandën e KFOR-it, gjenerali Ulutash merr detyrën



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BURIM RAMADANI, ANALIST I SIGURISË | FAQE 4-5

KOSOVA KA NEVOJË PËR GARANCI SIGURIE

Burim Ramadani, analist i sigurisë, ka thënë se ngjarjet e 24 shtatorit 2023 në veri kanë hapur një faqe të re të kërcënimeve të sigurisë, në mënyrë krejtësisht të ngjashme me ato që janë parë në vitet 2014-2015 në lindje të Ukrainës, përkatësisht në rajonin e Donetskut. Në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Ramadani ka thënë se atë që rusët e kishin bërë në Donetsk,

Serbia tentoi ta shtrijë praktikisht edhe në veri të Kosovës. Ai ka theksuar se ende rreziqet dhe kërcënimet e sigurisë janë serioze. "Planet për ta ndarë territorin e Kosovës janë serioze. Operacionet për të organizuar një lloj kryengritje janë serioze", ka thënë Ramadani, duke shtuar se Serbia me sulmin e 24 shtatorit ka hapur një fazë të re të tentimit për destabilizim të Ballkanit



Reagim i KMDLNj-së

MUNGESA E TRANSPARENCËS, PROVAT E SAJUARA, SHENJA IDENTIFIKUESE E GJYKATËS SPECIALE NË HAGË!



AKTUALE



IZRAELI PO I VAZHDON BOMBARDIMET NË GAZA

OSMANI NË ZAGREB: KOSOVA DHE KROACIA E KUPTOJNË DHE PËRKRAHIN NJËRA-TJETRËN PA KUSHTE

KOSOVA DHE SHQIPËRIA, NJËSI TË PËRBASHKËT HETIMORE PËR LUFTIMIN E KRIMIT

EKONOMI



"INATET POLITIKE" BLOKOJNË MILIONA EURO INVESTIME

BUMI TURISTIK NË SHQIPËRI DO TA NDRYSHOJË LIGJIN

SPORT



RAHMANI DHE ZYBA: NDAJ ANDORRËS LUAJMË PËR FITORE

RENOVA
PUTZ
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Osmani në Zagreb: Kosova dhe Kroacia e kuptojnë dhe e përkrahin njëra-tjetrën pa kushte

PRISHTINË, 10 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, pas takimit me presidentin kroat Zoran Milanović, në një konferencë të përbashkët për medie të martën, ka thënë se miqësia dhe partneriteti ndërmjet dy vendeve mbetet i palëkundur. “Kosova dhe Kroacia e kuptojnë dhe përkrahin njëra-tjetrën pa kushte.

Jemi me fat që kemi një aleat të tillë në krah, që na qëndron pranë në kohë të mira e në kohë të vështira. Kjo përkrahje po dëshmohej edhe këto ditë teksa Kosova po ballafaqohet me pasojat e aktit të agresionit të Serbisë”, ka thënë Osmani. Presidentja Osmani nga Zagrebi ka folur edhe rreth sulmit terrorist të 24 shtatorit në veri të Kosovës, duke bërë thirrje sërish nga komuniteti ndërkombëtar që ta sanksionojë Serbinë për rolin e saj në këtë agresion ndaj shtetit të Kosovës.

Osmani ka thënë se nëse kjo nuk ndodh, shteti serb do t'i përsërisë sulmet terroriste e

agresionin ndaj shtetit të Kosovës. Ajo ka theksuar se më 24 shtator Serbia kishte synim ta aneksonte veriun e Kosovës. “Miqësia dhe partneriteti ynë është i rrënjësor thellë në vlerat e përbashkëta, të cilat shërbejnë si urë lidhëse ndërmjet shteteve tona e popujve tanë. Kosova në periudhën e fundit po përballet me një nga periudhat më të rënda në 25 vitet e fundit shkaku i veprimeve hibride e agresionit të sponsorizuar e të urdhëruar nga Serbia. Përmes kësaj shpresoj që partnerët tanë ndërkombëtarë do të dëshmojnë qartësi strategjike dhe veprime të vendosura për ta ndaluar përpjekjen e Serbisë për destabilizim jo vetëm të Kosovës, por edhe vetë rajonit. Ka pak shtete në Evropë që e kuptojnë sfidën me të cilën ne po përballlemi në Kosovë më mirë se Kroacia. Kroacia edhe vetë në fillim të viteve '90 u përball me një matricë të ngjashme atëherë nga regjimi i Millosheviqit”, ka thënë



Osmani, duke shtuar se pas aktit të agresionit të 24 shtatorit, fokusi duhet të jetë të vënia e të gjithë autorëve para drejtësisë së Republikës së Kosovës, marrja e garancive të forta të sigurisë, sidomos për ta

ruajtur kufirin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe frenimi i Serbisë, sanksionimi si masë parandaluese për sulme të tjera në të ardhmen. “Nëse kjo nuk ndodh, Serbia do të ndihet më e fuqishme, më e

inkurajuar nga mosndëshkimi për të vazhduar me akte të tjera e sulme të tjera në atë që, sipas të gjitha provave që kemi mbledhur deri më tani, ka qenë aneksimi i veriut të Kosovës”, ka thënë Osmani.

Turqia udhëheq komandën e KFOR-it, gjenerali Ulutash merr detyrën

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 TETOR - Gjeneralmajor Ozkan Ulutash e ka marrë të martën detyrën e komandantit të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, në një kohë kur tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë të larta pas sulmit të muajit të kaluar në veri të vendit. Kjo është hera e parë që KFOR-i do të udhëhiqet nga një komandant turk.

Ulutash e mori detyrën nga komandanti i deritanishëm italian, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia, gjatë një ceremonie në Prishtinë, duke u bërë komandanti i 28-të i misionit të NATO-s në Kosovë që nga viti 1999.

Duke folur pasi e mori detyrën, Ulutash tha: “Si komandanti i parë turk i KFOR-it e kuptoj



përgjegjësinë që e kam marrë. Duke e parë gjendjen e ndjeshme në Kosovë, po e marr komandën me përkushtim për t'i bërë të gjitha përpjekjet dhe për ta përdorur gjithë përvojën për t'u siguruar se kjo njësi e shquar do të shërbejë suksesshëm në të ardhmen siç

ka bërë në të kaluarën”. Policia e Kosovës u sulmua nga një grup i armatosur serbësh në fshatin Banjskë, në komunën e Zveçanit më 24 shtator, ku mbeti i vrarë rreshteri Afrim Bunjaku. Në luftimet që pasuan në manastirin e fshatit u vranë tre

sulmues serbë.

Serbia i ka hedhur poshtë akuzat e Kosovës se ajo qëndron pas sulmit të cilësuar nga autoritetet kosovare si “tentim për ta aneksuar veriun e Kosovës”.

Përgjegjësinë për sulmin në Banjskë e mori Millan

Radoičiq, ish-kryetari i Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë që ka mbështetur e Beogradit. Më 3 tetor Radoičiqi u arrestua, u mor në pyetje dhe u urdhërua të mbahej në paraburgim policor deri në 48 orë para se të lirohej një ditë më vonë.

Kush është Ulutash?

Karriera e tij ushtarake nisi pasi e përfundoi shkollën e mesme ushtarake më 1985 dhe Akademinë Ushtarake në vitin 1989. Që nga viti 2021 ka shërbyer drejtor për strategji në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë së Turqisë, ndërsa më parë kishte qenë komandant i përgjithshëm i Forcës së Reagimit të Shpejtë të NATO-s

në Turqi. Më parë Ulutash kishte mbajtur edhe pozita të tjera ushtarake, si: zëvendëskomandant i sektorit të Komandës së Përbashkët të NATO-s në Norfolk, drejtor i Qendrës për Studime Historike Ushtarake në Ankara dhe zëvendëskomandant i Garnizonit të Brigadës së 28-të të Këmbësorisë së Mekanizuar.

Izraeli po i vazhdon bombardimet në Gaza

Jerusalem, 10 tetor - Izraeli i ka vazhduar të martën bombardimet vdekjeprurëse ndaj Rripit të Gazës së kontrolluar nga Hamasi, pasi grupi militant kërcënoi se do t'i vriste disa prej rreth 150 pengjeve që i rrëmbeu në fundjavë, nëse sulmet ajrore do të vazhdonin pa paralajmërim.

Forcat e Mbrojtjes së Izraelit (FMI) njoftuan, po ashtu, se e kanë siguruar kufirin me Gazën, nga ku mijëra luftëtarë të Hamasit ishin futur në Izrael të shtunën për ta nisur sulmin më të rëndë ndaj këtij vendi në dekadat e fundit.

Zëdhënësi i FMI-së, Daniel Hagari, tha se në ditët e

fundit nuk ka mundur të futet asnjë militant në tokën izraelite nga Gaza. Ai tha se inxhinierët po i minojnë pjesët ku ishte prishur gardhi mbrojtës kufitar. Militantët e Hamasit e kishin thyer këtë barrierë të madhe në shumë pjesë për ta nisur sulmin.



REAGIM I KMDLNJ-SË

Mungesa e transparencës, provat e sajuara, shenja identifikuese e Gjykatës Speciale në Hagë!

Procesi ndaj presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli, kryetarë të Kuvendit të Kosovës, Rexhep Selimi, shëf i GP të partisë Vetëvendosje si dhe Pjetër Shala, ushtar i UÇK-së po vazhdon në rrethana të mungesës së theksuar të transparencës dhe redaktimeve të shumta që efektivisht shkaktojnë huti dhe mosbesim në opinion sikur që shkelin të drejtat e njeriut të personave që po gjykohen duke ua pakësuar mundësinë për mbrojtje. Nasim Haradinaj, Hysni Gucati dhe Salih Mustafa, më herët ishin dënuar me dënime kapitale dhe drakonike, të pashembullta me dënimet e gjykatave që trajtojnë raste të kësaj natyre. Risi e kësaj Gjykate, nga aspekti i të drejtave të njeriut pa asnjë dyshim raciste (sepse të gjitha arrestimet, gjykimet dhe dënimet janë në baza etnike) është numri i madh i të arrestuarve dhe atyre që merren në pyetje për një vepër që është risi, pengimi i administrimit të drejtësisë dhe frikësimi i dëshmitarëve e që është numër më i madh se i atyre që janë arrestuar, po gjykohen apo që janë dënuar. Në njërin anë, Gjykata Speciale përkatësisht Prokuroria e Specializuar nuk lë mjet pa keqpërdorur për të ardhur te provat kundër atyre që po gjykohen apo që janë dënuar duke filluar nga fakti që shumica e

provave janë siguruar nga shteti i Serbisë përkatësisht nga shërbimet inteligjente të këtij shteti që ka kurditur prova dhe dëshmitarë, ka joshur dëshmitarë me para dhe premtim për strehim në një vend tjetër, ka hyrë në marrëveshje me dëshmitarë të ndryshëm, ka marrë deklarata në prani të prokurorëve të Serbisë dhe ka trajnuar dëshmitarë se si duhet të dëshmojnë. Në anën tjetër kanë përndjekur çdo person, që në një mënyrë apo tjetër ka kundërshtuar këto metoda të Prokurorisë Speciale duke i ftuar në biseda, duke ua konfiskuar telefonat, kompjuterët, librat apo publikimet e tjera sikur edhe duke i marrë për bazë edhe deklaratat e të ashtuquajtur analistë që nuk kanë lënë vend dhe mundësi që, për përfitime krejtësisht materiale të deklarohen kundër luftës ndonëse nuk kanë pasur asnjë njohuri, shkak i moshës apo bindjeve politike të sigurojnë ndonjë provë për periudhën për të cilën janë deklaruar. Kishte dëshmitarë të organizatave me nam që dëshmuar se raportet e tyre janë bazuar në raporte të mediave serbe dhe institucioneve serbe sikur edhe organizatave në Kosovës që edhe ato mbështeteshin në të njëjtat burime. Rast flagrant është se dëshmitari që edhe tani është duke dëshmuar, serb i Serbisë që qenka ndaluar, sipas tij nga UÇK-ja



botërisht e pranon se deklaratën fillimisht e ka dhënë te prokurori serb në Beograd ndërsa, po të njëjtën deklaratë e paska dhënë para Prokurorit të Specializuar, në praninë dhe shoqërimin e prokurorit të Serbisë!!!! Dritan Goxhaj ishte arrestuar në Shqipëri me urdhër të Gjykatës Speciale me arsyetim se paska përmendur në një intervistë emra të dëshmitarëve të mbrojtur e që janë bartës të posteve publike në Kosovës ndërkaq që Gjykata e Apelit në Shqipëri duke e refuzuar ekstradimin e tij në Hagë, urdhëroi që ai të lirohet që dëshmon qartazi se kjo gjykatë ka identitet profesional dhe moral. Mundësia më e madhe për frikësim të atyre që e kundërshtojnë këtë Gjykatë është pikërisht arrestimi për pengim të drejtësisë që është aq

fleksibil sa që mund të krijojë mundësi për arrestim të qindra personave sikur që dikur UDB-ja dhe autoritetet jugosllave dhe serbe e interpretonin propagandën armiqësore si pretekst për arrestim dhe gjykim të qindra dhe mijëra shqiptarëve, kundërshtarë të regjimit reperesiv jugosllav dhe serb. Proceset e deritashme para Gjykatës Speciale janë në masën 85% procese të mbyllura për publikun, procese private në një proces të privatizuar dhe të kapur andaj është e paqartë se çka ndodhë aty dhe në mënyrën më flagrante shkelet parimi i publicitetit që garanton dhe mbron të drejtat e të akuzuarve për një proces të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar politikisht apo nga grupet e tjera të interesit ku publiku rregullisht dhe

objektivisht informohet për rrjedhën e gjykimin. Shumica e dëshmitarëve të "mbrojtur" nuk janë dëshmitarë të drejtpërdrejtë, nuk janë dëshmitarë okularë që e ul dukshëm besueshmërinë e dëshmitarëve të tyre aq më parë që pas dëshmitarëve janë transferuar në shtetet tjera, bashkë me familje ku i është dhënë strehim. Kjo mënyrë është joshje edhe për dëshmitarët tjerë të cilët gjithashtu janë dëshmitarë kolateralë. Merreni me mend, dëshmia e një dëshmitari kolateral e që tani jeton në një vend tjetër deri më tani ka pasur për pasojë arrestimi e disa personave dhe marrje në pyetje të dhjetëra të tjerëve. KMDLNj kërkon hapje të proceseve gjyqësore, redaktim vetëm kur nuk ka tjetër mundësi për çka ka dhënë premtime publike edhe kryetari i trupit gjykues në procesin kundër krerëve ushtarakë dhe politikë dhe institucionalë, të gjithë shtetas të Kosovës dhe të gjithë shqiptarë në të kundërtën përgjegjësia do të adresohet edhe te deputetët e Kuvendit të Kosovës si bashkëpjesëmarrës në shkelje të të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në Hagë. Reagimi i deputetëve të Kuvendit të Kosovës në adresimin e çështjeve që janë ngritur nga KMDLNj në asnjë mënyrë nuk janë ndërhyrje në pavarësinë e kësaj gjykate por janë çështje e të drejtave të njeriut.

Shqipëria refuzon ta ekstradojë, e liron ish-anëtarin e UÇK-së



PRISHTINË, 10 TETOR - Gjykata e Apelit e Shqipërisë e ka liruar të martën ish-anëtarin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Dritan Goxhaj, pasi e hodhi poshtë kërkesën për ekstradimin e tij në Dhomat e Specializuara në Kosovë.

Goxhaj ishte arrestuar më 31 korrik në Shqipëri, patën njoftuar Dhomat e Specializuara, me seli në Hagë, asokohe. Të martën Gjykata e Apelit e Shqipërisë tha se vendosi ta ndryshojë vendimin e gjykatës

së shkallës së parë dhe urdhëroi "lirimin e menjëhershëm të tij". Si pasojë "rrezohet kërkesa për ekstradimin e Dritan Goxhajt nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, hiqet masa e sigurimit 'arrest në burg'", thuhet

në njoftim. Ai ishte arrestuar në bazë të një fletarrestimi si i dyshuar për vepra penale të frikësimin dhe pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave. Ai dyshohet se kishte publikuar emrat e dëshmitarëve në disa

çështje penale që janë ngritur pas luftës në Kosovë. Arrestimi u krye në bashkëpunim me autoritetet shqiptare dhe kjo ishte hera e parë që Gjykata Speciale kryente arrestim në territorin e Shqipërisë.

FLET PËR “EPOKËN E RE” BURIM RAMADANI, ANALIST I SIGURISË

Kosova ka nevojë për garanci sigurie

Burim Ramadani, analist i sigurisë, ka thënë se ngjarjet e 24 shtatorit 2023 në veri kanë hapur një faqe të re të kërcënimeve të sigurisë, në mënyrë krejtësisht të ngjashme me ato që janë parë në vitet 2014-2015 në lindje të Ukrainës, përkatësisht në rajonin e Donetskut. Në një intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Ramadani ka thënë se atë që rusët e kishin bërë në Donetsk, Serbia tentoi ta shtrijë praktikisht edhe në veri të Kosovës. Ai ka theksuar se ende rreziqet dhe kërcënimet e sigurisë janë serioze. “Planet për ta ndarë territorin e Kosovës janë serioze. Operacionet për të organizuar njëllor kryengritje janë serioze”, ka thënë Ramadani, duke shtuar se Serbia me sulmin e 24 shtatorit ka hapur një fazë të re të tentimit për destabilizim të Ballkanit

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 TETOR-

“Epoka e re”: Z. Ramadani, si e shihni situatën në veri pas sulmit terrorist të 24 shtatorit?

Ramadani: Ngjarjet e 24 shtatorit 2023 kanë hapur një faqe të re të kërcënimeve të sigurisë, në mënyrë krejtësisht të ngjashme me ato që janë parë në vitet 2014-2015 në lindje të Ukrainës, përkatësisht në rajonin e Donetskut. Është e njëjta shkollë e kërcënimeve. Doktrina dhe metodologjia ruse u praktikuan në veri të Kosovës. Atë që rusët e kishin bërë në Donetsk, Serbia tentoi ta shtrijë praktikisht edhe në veri të Kosovës. Fatmirësisht, operacioni i Serbisë doli të mos ketë sukses, kryesisht për shkak të reagimit të shpejtë dhe profesional të Policisë së Kosovës, porse ky duket që është një plan më i gjerë dhe më i gjatë, prandaj operacione të tilla apo të ngjashme mund të përsëriten sërish dhe sërish.

“Epoka e re”: A ka ende rreziqe për sigurinë?

Ramadani: Rreziqet dhe kërcënimet e sigurisë janë serioze. Planet për ta ndarë territorin e Kosovës janë serioze. Operacionet për të organizuar njëllor kryengritje janë serioze. Prandaj, edhe reagimet, planifikimet dhe koordinimet vendore e ndërkombëtare duhet të jenë serioze në vazhdimësi. Nuk mund të përjashtohen asesi opsionet që prapa këtij operacioni të grupit paramilitar të Serbisë qëndrojnë mësuesit rusë të Qendrës Ruso-Serbe të Spiunazhit në Nish të Serbisë. Sepse praktika ruse në lindjen e Ukrainës është tentuar të demonstron në veri të Kosovës. Metodologjia e njëjtë, qëllimi i njëjtë, operacioni i njëjtë. Fatmirësisht, rezultati i ndryshëm.


“Epoka e re”: Ju keni reaguar në rrjete sociale dhe në disa intervista në televizione, duke thënë se Serbia përmes këtij grupi paramilitar ka kërcënuar edhe trupat ushtarake të NATO-s.

Ramadani: Absolutisht, trupat ndërkombëtare janë rrezikuar direkt, jo vetëm Kosova. Normalisht se operacioni i ushtrisë dhe agjencive të sigurisë së Serbisë kanë qenë të orientuara për të kapur një terren territorial brenda Kosovës, porse rrezikimi i trupave ndërkombëtare, trupave të NATO-s, ka qenë i paprecedentë. Çka u thonë shtetet e NATO-s popujve të vet: Pse dhe kush ua rrezikoi jetën ushtarëve të tyre?

“Epoka e re”: A është dashur që KFOR-i të reagojë atë ditë kur dihet se kemi pasur shkëmbim zjarresh në mes të Policisë së Kosovës dhe atij grupi kriminal, sepse është rrezikuar edhe jeta e banorëve në këtë pjesë?

Ramadani: KFOR-i, sikurse edhe institucionet vendore, do të duhej ta analizojnë secilin detaj çka u mungoi ato ditë që nuk detektuan hyrjen e këtyre paramilitarëve, pajisjeve të tyre të shumta ushtarake, veturave dhe blindave. Pse pikërisht në ato ditë Ushtria e Serbisë po bënte stërvitje ushtarake afër Kosovës dhe një kolonë me automjete, pajisje dhe grup paramilitar hyri në Kosovë si në terren të vet? Çfarë lëshimesh profesionale dhe teknike kanë ndodhur që të mos detektohet një grup i tillë paramilitar, me pajisje dhe automjete?

Përfshirja në operacion të datës 24 shtator 2023 dhe e KFOR-it ka qenë në bazë solide, porse jo në trupa të ndërhyrjes. Sepse komunikimi, koordinimi dhe shkëmbimi i informacionit duket se ka qenë i saktë dhe i shpejtë në



ditën kritike. Sidoqoftë, Policia e Kosovës ka pasur kapacitete të mjaftueshme për të intervenuar ashtu sikurse ka intervenuar.

“Epoka e re”: Serbia me këtë sulm terrorist a mendoni se ka provuar një skenar të ri në veri, që situata të

marrë kahe tjetër?

Ramadani: Serbia ka hapur një fazë të re të tentimit për destabilizim të Ballkanit. Po e bën në mënyrë krejtësisht të çmendur, sepse po dëshiron të tentojë të luftojë me të njëjtin armik ndaj të cilit e ka humbur luftën në vitin

1999. Pra, të luftojë edhe kundër Kosovës dhe kundër NATO-s në të njëjtën kohë. Fatkeqësisht, NATO po e mban Serbinë edhe më tutje në Partneritet për Paqe. Paramendojeni! Serbia në Kosovë rrezikon pikërisht ushtarët e NATO-s, ndërsa në rajone të tjera

Kurti në Konferencën Vjetore të Partisë Laburiste flet për qeverisjen e tij socialdemokrate në Kosovë

PRISHTINË, 10 TETOR - Kryeministri Albin Kurti ka marrë pjesë në Konferencën Vjetore të Partisë Laburiste të Mbretërisë së Bashkuar në Liverpool. Ai ka thënë se laburistët na kanë shoqëruar në dy prej momenteve me historike të vendit. "Partnerë të kohës e të dëshmuar ndër vite, ata i kishim përkrah në çlirim dhe pavarësi, e Mbretërinë e Bashkuar aleatë të pazëvendësueshëm në zhvillim dhe afirmim. Dje, para fillimit të

drekës së punës së partive simotra, u mirëprita nga sekretari nën hije për Punë të Jashtme i Mbretërisë së Bashkuar, David Lammy. Në margjina takova edhe sekretarin nën hije të Mbrojtës, John Healey, si dhe sekretarin e përgjithshëm ekzekutiv të Partisë Evropiane të Socialistëve (PES), Giacomo Fillibeck", ka thënë Kurti.

Kryeministri tha se ishte i nderuar që si folës kryesor në

drekën me partitë simotra të mund ta paraqiste qeverisjen e tij socialdemokrate në Kosovë, reformat e ndërmarra, politikat sociale dhe të punësimit, ato të energjisë dhe në arsim, fushat prioritare të qeverisë sipas buxhetit të këtij viti, indikatorët ekonomikë dhe progresin demokratik të njohur edhe nga raportet kredibile

ndërkombëtare. "E krahas tyre, edhe sidat dhe pengesat që na bën Serbia në vazhdimësi, deri te

sulmi terrorist e paramilitar i 24 shtatorit i sponsorizuar nga shteti serb, dhe rreziku që autokratët dhe politikat e tyre hegjemoniste dhe ekspansioniste paraqesin për sigurinë dhe paqen", ka theksuar Kurti.

Ai ka bërë me dije se gjatë drekës ka takuar dhe biseduar me socialdemokratë të shumtë, në mesin e tyre me Andrew Giles, ministër i Imigrimit, Shtetësisë, Shërbimeve të Migrimit dhe Çështjeve

Multikulturore të Australisë, Stephen Smith, komisionar i lartë i Australisë në Mbretërinë e Bashkuar, Annelise Dodds, sekretare në Hijë e Shtetit për Gra dhe Barazi, Francois Comet, zëvendëssekretar nacional për Evropë i Partisë Socialiste në Francë, Thijs Reuten, eurodeputet holandez në Parlamentin Evropian, Tsvetelina Penkova, eurodeputete bullgare në Parlamentin Evropian dhe Baroneshën Hayter.



bashkë me NATO-n ofron paqe. Kjo është më shumë se hipokrizi. Prandaj, unë besoj plotësisht se NATO do ta përzë Serbinë nga Partneriteti për Paqe. Serbia ka dëshmuar që nuk është partnere serioze dhe kredibile për operacione të përbashkëta me NATO-n në paqe. Ajo është kundërshtarë e NATO-s, sepse të tillë e ka padronin, përkatësisht Putinin.

Kështu, Serbia edhe njëherë i ka shërbyer qëllimit nacional të Rusisë. Ka tentuar të nisë një konflikt të hapur në Ballkan, kësaj radhe edhe kundër NATO-s. Qëllimi është i identifikueshëm, sepse Rusisë i duhet dëshpërimisht të hapen konflikte në zona të tjera të botës, ku NATO dhe ShBA-ja janë të interesuara të ketë paqe dhe stabilitet.

"Epoka e re": Po reagimi i institucioneve tona, qeverisë, atyre të sigurisë, Policisë së Kosovës, pas këtij sulmi, çfarë duhet të jetë?

Ramadani: Institucionet e sigurisë duhet ta vazhdojnë punën e tyre

në nivel të lartë të vigjencës, duke pasur parasysh se operacioni i Serbisë nuk besoj të ketë përfunduar. Koordinimi midis institucioneve të sigurisë është i domosdoshëm dhe duhet vazhdimisht të jetë i plotë. Jam i sigurt që sektori i sigurisë në Kosovë është profesional, i ndërtuar dhe kompletuar në nivel të lartë të standardeve demokratike dhe, si i tillë, komunikon në nivele të zhvilluara profesionale. Kosova ka sektorë profesionalë të sigurisë, por qeverisje të dobët politike e diplomaci të përgjumur. Shumë prej zhvillimeve të sigurisë ose janë pasojë e mosrezultateve politike ose pikënisje për ofensiva politike. Kështu, Kosova duhet të jetë në ofensivë politike e diplomatike. Kosova duhet të jetë në tavolinat profesionale (jo vetëm politike) të secilit shtet anëtar të NATO-s dhe BE-së. Fitoret më të mëdha arrihen në adresën e duhur. Strategjia e Kosovës nuk duhet të jenë taktikat operacionale, por taktikat

operacionale duhet të shërbejnë një strategji nacionale. Sepse, taktikat shpeshherë janë reaguese, ndërsa Kosova ka nevojë të jetë në prirje të proceseve.

"Epoka e re": Si e keni parë reagimin ndërkombëtar për këtë ngjarje, sepse ka pasur opinione se drejtuesit e dialogut nga BE-ja, Borell e Lajçak, kanë reaguar ftohtë. Nuk kemi pasur një reagim dënuar të fuqishëm ndaj Serbisë. Pra në përgjithësi cila do të duhej të ishte gjuha me të cilën ndërkombëtarët duhet ta cilësojnë këtë sulm terrorist të 24 shtatorit?

Ramadani: Besoj se fokusi i Kosovës duhet të jetë NATO. Edhe për faktin që shumica e shteteve të BE-së janë anëtare të NATO-s, edhe për faktin që NATO udhëheq trupat ushtarake në Kosovë, edhe për faktin që NATO e ka për mision ruajtjen e Kosovës nga invazioni serb. Kur situata në terren merr dimension serioz të sigurisë, NATO është ajo që duhet të prijë në vendosmërinë e saj. Kështu, nuk është e habitshme

përse përfaqësuesit diplomatikë të BE-së nuk kanë kapacitetin institucional të veprimit, përpos atë deklarativ për aspekte të sigurisë. Porse, unë besoj se Kosova duhet të jetë e mirorganizuar, me të gjithë institucionet dhe njerëzit në Kosovë që ta promovojë qëllimin nacional të Kosovës për anëtarësim të privilegjuar në NATO. Pra, Kosova duhet të jetë anëtare e NATO-s në proces të privilegjuar. Të ndërtuar enkas për Kosovën, të dizajnuar në kuptimin procedural vetëm për Kosovën.

Por, për të shërbyer në këtë qëllim, pothuajse gjithçka në Kosovë duhet të funksionalizohet më mirë dhe më ndryshe. Për shembull, pse Kosova pas 24 shtatorit 2023 nuk i ka nisur të paktën 10 diplomatë që të punojnë në Bruksel, të komunikojmë me NATO-n, me shtetet anëtare të NATO-s? Kush e ndalon Kosovën që t'i shumëfishojë diplomatët apo të krijojë ekipe profesionale për ta

promovuar rastin e Kosovës në Bruksel apo në shtetet anëtare të NATO-s?

"Epoka e re": Sa është e vështirë të rikthehen në tavolinën e bisedimeve Kosova e Serbia. A rrezik që dialogu të ngeçë?

Ramadani: Për bindjen time, Kosova ka nevojë për garanci sigurie. Garancitë në këtë kuptim nuk janë aspekte deklarative, por konkrete dhe praktike. Një hapje e shtegut për Kosovën në NATO do ta ndihmonte edhe sigurinë e stabilitetin rajonal, por në një aspekt do t'i ndihmonte edhe proceset politike sikurse është edhe dialogu Kosovë - Serbi. Kosova ka obligime brenda vetes dhe me partnerët ndërkombëtarë. Tekefundit, dialogu mund dhe duhet të shihet si bashkëveprim në mes të Kosovës dhe NATO-s. Pra, është koha për aranzhmane të reja mes NATO-s dhe Kosovës, të cilat do të mundësonin që proceset politike të zhvillohen në dimensione politike dhe jo të sigurisë.

Kosova dhe Shqipëria, me njësi të përbashkët hetimore për luftimin e krimit

PRISHTINË, 10 TETOR - Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), Blerim Isufaj dhe kreu i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së Shqipërisë (SPAK), Altin Dumani, kanë nënshkruar të martën marrëveshje me të cilën kanë formuar njësinë e përbashkët hetimore, të përbërë nga prokurorë të të dyja

prokurorive përkatëse. Sipas njoftimit të prokurorisë, qëllimi i nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje në mes të dy krerëve të institucioneve të ndjekjes parashikon bashkëpunim të ngushtë të veprimeve të dy prokurorive në fusha të rëndësishme të luftës kundër krimit. Isufaj dhe Dumani nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje e kanë vlerësuar të rëndësishëm duke theksuar se

ky është një hap drejt përmirësimit të sigurisë dhe sundimit të ligjit në dy shtetet përkatëse, si dhe drejt ndërtimit të një partneriteti të fortë mes dy institucioneve të drejtësisë. Nënshkruarit e marrëveshjes janë zotuar për bashkëpunim të ngushtë në luftimin e të gjitha formave të krimit që prekin interesat ekonomike, financiare dhe shoqërore të të dyjave vendeve.



Kuvendarët e Gjilanit miratojnë kërkesën për ndarjen e 160 mijë eurove për shtatorët e Kadri Zekës e Ramiz Cërnicsës

GJILAN, 10 TETOR - Kuvendi i komunës së Gjilanit, nën drejtimin e kryesuesit Kushtrim Kadriu, në seancën e së martës, që është vazhdim i asaj të 29 shtatorit, e cila u ndërpre dy herë radhazi për mungesë kuorumi, ka miratuar kërkesën e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për ndarjen e shumës financiare prej 160 mijë eurosh për realizimin e shtatoreve të heronjve Kadri Zeka e Ramiz Cernica.

Kërkesa mori përkrahjen e 21 asamblistëve prezentë në sallë (LDK, PDK, AAK, Vatra dhe një pjesë e LV-së), ndërkaq opozita bëri vërejtje për mospraninë e sponsorizuesit të kësaj kërkesë. Kuvendi i komunës, gjithashtu, ka votuar për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për formimin e Komisionit për ndarjen e bursave për studentë të Gjilanit, plotësim-ndryshimin e vendimit për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionareve në NPL "Stacioni i Autobusëve" Gjilan, sikurse edhe kërkesën e SHIL të



UÇK-së, dega në Gjilan, për ndarjen e mjeteve financiare. Në këtë seancë me 14 vota për është miratuar edhe kërkesa për subvencionimin e regjistrimit të fëmijëve në institucionet

parashikore private në shumën prej 40 eurove, ku kriteri është për prindërit e fëmijëve që s'kanë të ardhura mujore më shumë se 528 euro, të cilën e ka arsyetuar shefi i grupit të këshilltarëve të LDK-së,

Avdyl Aliu. Paraprakisht, LV-ja dhe PDK-ja kanë kërkuar që kjo pikë të shtyhet për seancën e ardhshme për shkak të paqartësisë së sigurimit të buxhetit për këtë çështje.

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Gjilanit për vitin 2022 është shtyrë për seancën e radhës për shkak të mospranisë së kryetarit të komunës.

Hoti takon Edward Josephin: Zgjidhja e vetme është dialogu dhe koordinimi me aleatët tanë



PRISHTINË, 10 TETOR - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka takuar mbështetësin e fortë të integritit euroatlantik të Kosovës, Edward Joseph. Hoti ka bërë me dije se zhvilluan një bisedë shumë përmbajtjesore për zhvillimet aktuale politike në vend si dhe rëndësinë për stabilitet në rajon. "Z. Joseph është njohës shumë i mirë i

zhvillimeve politike në Ballkan. I dëgjova me shumë interes pikëpamjet e tij lidhur me situatën aktuale. Theksova se Kosova duhet të jetë promovuese dhe kontribuuese e stabilitetit rajonal. Tregova pikëpamjet e LDK-së për dialogun dhe zhvillimet aktuale politike. Për LDK-në, zgjidhja e vetme është dialogu dhe koordinimi me aleatët

tanë", ka shkruar Hoti në "Facebook". Ai ka theksuar se marrëveshja gjithëpërfshirëse për njohje reciproke dhe normalizim të marrëdhënieve është zgjidhja e vetme që siguron paqe të përhershme në këtë pjesë të Evropës. "E falënderova për kontributin e tij ndër vite që ka bërë për Republikën e Kosovës", ka deklaruar Hoti.

Laboratori i QKMF-së në Drenas po punon me kapacitet të plotë

DRENAS, 10 TETOR - Komuna e Drenasit ka njoftuar se laboratoritë e QKMF-së në Drenas është duke punuar me kapacitet të plotë, me dy turne. Turni i parë nga ora 08:00 deri në orën 15:00,

ndërsa turni i dytë nga ora 13:00 deri në orën 20:00. "Vlen të ceket se turni i dytë i cili fillon në orën 13:00 dhe mbaron në orën 20:00 kryen shërbime vetëm sipas urgjencës. Drejtorja për

Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale mbetet e përkushtuar për ofrimin e shërbimeve cilësore për të gjithë qytetarët e komunës sonë", ka njoftuar komuna e Drenasit.



'Inatet politike' bllokojnë miliona euro investime



PRISHTINË, 10 TETOR - Nga inatet politike është duke pësuar mirëqenia e qytetarëve të Kosovës. Këtë vlerësim japin përfaqësues të shoqërisë civile teksa komentojnë bllokimin e së paku shtatë marrëveshjeve ndërkombëtare në Kuvendin e Kosovës. "Pasoja lidhen direkt me interesin e qytetarëve, pasi shumica e marrëveshjeve janë kredi për financimin e projekteve, të cilat, nëse zbatohen në praktikë, mund ta përmirësojnë mirëqenien e qytetarëve në disa fusha", thotë për "Radion Evropa e Lirë" Violeta Haxholli nga Instituti Demokratik i Kosovës. Marrëveshjet që nuk kaluan në seancat e 4 dhe 5 tetorit kanë të bëjnë, mes të tjerash, me kredi për zhvillimin e sektorit të energjisë, të linjave hekurudhore dhe të ngrohjes, si dhe me bursa për studentë. Me ligjin në Kosovë marrëveshjet ndërkombëtare mund të ratifikohen vetëm me votat e 2/3 së deputetëve - përkatësisht të 80 nga 120 sa ka Kuvendi i Kosovës. Por, shumë deputetë të partive opozitare - pa votat e të cilëve s'mund të arrihet shumica - janë zotuar se nuk do të votojnë asnjë të tillë, derisa vendi nuk shkon në zgjedhje të reja. Ata nuk kanë problem me përmbajtjen e marrëveshjeve, por kundërshtojnë politikën e qeverisë së udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje. Haxholli, nga Instituti Demokratik i Kosovës, i cili monitoron punën e Kuvendit të Kosovës, thotë se marrëveshjet që nuk kaluan javën e kaluar kanë qenë në rend dite në 28 seanca të Kuvendit që nga muaji prill. Mosmiratimi i tyre prek direkt

jetën e qytetarëve, thonë edhe në organizatën joqeveritare, Lëvizja Fol. "Kjo duhet të merret parasysh nga partitë në Kuvend. Interes kryesor duhet të jetë mirëqenia e qytetarëve", thotë Mexhide Demolli, drejtoreshë ekzekutive e kësaj lëvizjeje.

Çfarë përmbajnë shtatë marrëveshjet në fjalë?

Marrëveshjet së bashku me vlerësimin e ndikimit financiar janë të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës. Një nga to është Marrëveshja e Kredisë për Programin e Financave Publike dhe Rritjes Ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar. Me vlerë prej 40 milionë dollarësh, marrëveshja parasheh mbështetje të drejtpërdrejtë për buxhetin e Kosovës, që do të shfrytëzohej për zhvillimin e sektorit privat. Tjetër është Marrëveshja në mes të Ministrisë së Arsimit të Kosovës dhe Ambasadës së Francës në Prishtinë në vlerë prej 4.6 milionë eurosh. Qëllimi i saj është lëvizja e studentëve të arsimit të lartë dhe ndarja e bursave për ta. Ndërtimi i një impianti solar dhe zgjerimi i rrjetit të ngrohjes për qytetin e Prishtinës presin ratifikimin e Marrëveshjes për Kredi në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Vlera e kredisë do të ishte 23 milionë euro. Marrëveshja tjetër në mes të Kosovës dhe Bankës gjermane KfW, në vlerë prej 25.5 milionë eurosh, do të shfrytëzohej nga Operatori i Sistemit të

Transmisionit të Tregut (KOSTT), me qëllim zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike. Marrëveshja me Bankën Evropiane për Investime për projektin "Rehabilitimi i linjës hekurudhore" kap vlerën e 38 milionë eurove. Mbi 20 milionë euro për sektorin e bujqësisë në zonat rurale të Kosovës parasheh Marrëveshja në mes të Ministrisë së Bujqësisë dhe Agjencisë gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ). Dhe - e fundit në këtë grup - Marrëveshja mes Qeverisë së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e institucionit korrektues në Gjilan do të siguronte të ardhura buxhetore prej 177.5 milionë eurosh - prej tyre 27.5 milionë euro si grant për investime në energji të ripërtërishe.

Çfarë thonë partitë opozitare?

Partia Demokratike e Kosovës - subjekti më i madh opozitar - ka marrë qëndrim që të mos votojë ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare, derisa qeveria aktuale, e udhëhequr nga Albin Kurti, është në pushtet. Ferat Shala nga kjo parti fajëson pushtetin për, siç thotë, keqmenaxhim të buxhetit dhe mosbashkëpunim me aleatët ndërkombëtarë. Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", Shala thotë se u referohet keqpërdorimeve të dyshuara me Rezervat Shtetërore dhe thirrjeve të padëguara të Qeverisë së Kosovës për ta shtensionuar situatën në veri - zonë e banuar me shumicë

serbe. "Në esencë, ne jemi pro kredive, jemi pro partnerëve që na kanë subvencionuar, jemi pro bashkëpunimit dhe thellimit, por me një qasje dhe menaxhim ndryshe nga partia në pushtet", thotë Shala, partia e të cilit ka 18 deputetë në Kuvendin e Kosovës. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila ka 16 deputetë në Kuvend, thonë se nuk pajtohen me shumë veprime të qeverisë, por sa iu përket marrëveshjeve ndërkombëtare kundërshtojnë vetëm votimin e njërës - asaj me Fondin OPEC. Pa dhënë shumë hollësi, deputeti i kësaj partie thotë se "qasja e gabueshme e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, po sjell dështimin e miratimit të marrëveshjeve". Time Kadriaj nga partia tjetër opozitare, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, thotë se as ky subjekt, që ka tetë deputetë, nuk do të votojë marrëveshje ndërkombëtare derisa të jetë në pushtet qeveria Kurti. "Votojmë nëse ka ndonjë reflektim edhe nga ana e mazhorancës", thotë Kadriaj, duke shtuar se partia e saj ka dalë me disa iniciativa - përfshirë rritjen e koeficientit të pagës për punonjësit e sektorit publik - që nuk janë përkrahur nga pushteti. Duke folur për këtë çështje më 5 tetor, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se nga mosmiratimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, pësojnë qytetarët. "Vlera e tyre tejkalon shifrën prej 360 milionë eurosh. Janë kredi të buta, grante, para falë, që nuk duhet të kthehen fare dhe do të investoheshin në projekte zhvillimore", ka thënë ai. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë në

seancën e 4 tetorit se, nëse një legjislaturë nuk e ka kapacitetin të kalojë marrëveshje ndërkombëtare, ajo nuk ia vlen të ekzistojë. "Radio Evropa e Lirë" pyeti Zyrën për Informim të Kuvendit të Kosovës se cilët do të jenë hapat e mëtejshëm apo pasojat nga mosmiratimi i këtyre marrëveshjeve, por nuk mori përgjigje.

E kujt është përgjegjësia?

Haxholli nga Instituti Demokratik i Kosovës thotë se partitë politike në opozitë nuk kanë vërejtje për përmbajtjen e marrëveshjeve, por vetëm "inate të tjera politike". Sipas saj, edhe pushteti duhet të angazhohet më shumë për të gjetur një konsensus. "Ne e dimë që gjithmonë ka mospajtime në mes të pushtetit dhe opozitës. Natyrisht se përgjegjësinë për konsensus e ka partia në pushtet, e cila duhet t'u prijë përpjekjeve për të gjetur zgjidhje, pasi ka përgjegjësinë kryesore për efikasitet në qeverisje", thotë Haxholli. Demolli nga Lëvizja Fol thotë se përgjegjësia bie mbi të dyja palët. "Kjo duhet të zgjidhet, sepse votuesit, qytetarët duan investime, si në energji, punësim dhe sektorë të tjerë", thotë ajo. Nga viti 2021 kur është formuar, përbërja aktuale parlamentare ka miratuar 45 marrëveshje ndërkombëtare në fusha të ndryshme, thuhet në faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës. Kritikant e opozitës ndaj pushtetit janë shpeshuar kohën e fundit qoftë për menaxhimin e krizave në veri apo për qasjen në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

Bumi turistik në Shqipëri do ta ndryshojë ligjin



TIRANË, 10 TETOR - Bumi turistik në Shqipëri sezonin që shkoi nuk u përkthye edhe në bum ekonomik. Këtë shqetësim kryeministri i këtij vendi, Edi Rama, ua shprehu hapur operatorëve turistikë, duke thënë se “nuk mundet që sipërmarrja të fitojë, ndërkohë që arka e shtetit lëngon”.

Për ta formalizuar më tej këtë sektor, qeveria hodhi për konsultim disa ndryshime në Ligjin për Turizmin. Ekspertët thonë se ndryshimet janë të nevojshme, të tjerë mendojnë se duhet të ishin bërë më herët.

Të dhënat e Ministrisë së Turizmit tregojnë se rreth 8.3 milionë turistë të huaj e vizituan Shqipërinë në 9 muajt e parë të këtij viti, edhe pse numri i deklaruar nga të gjitha strukturat akomoduese është më i ulët.

Shifra zyrtare, megjithatë, paraqet rritje për gati 30 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Operatorët turistikë: Ndryshime të nevojshme, informalitet i lartë

Zak Topuzi, kryetar i Shoqatës së Hotelieri-Turizmit në Shqipëri, thotë se kjo organizatë ka kërkuar vazhdimisht që Ligji për Turizmin, i miratuar në vitin 2015, të ndryshojë. “Vitet e fundit ka pasur zhvillime të mëdha. Duke mos paguar taksa, disa individë apo biznese sigurojnë të ardhura që, në njëfarë mase, dëmtojnë tregun. Gjithashtu, humbet edhe mbrojtja e konsumatorit, pasi nuk janë të

certifikuar dhe të standardizuar”, thotë Topuzi.

Ai shton se tash e gjashtë muaj shoqata e tij ka bërë këtë kërkesë për formalizim të tregut, duke theksuar se vendet e tjera të Ballkanit e kanë kryer me kohë këtë proces. “Janë mbi 8 000 subjekte që shesin online, ndërkohë janë 4 000 ose më pak biznese të deklaruara. AirBNB dhe Booking na kanë thënë se kërkesa për formalizim duhet të vijë nga institucionet”, thotë Topuzi duke iu referuar platformave online për akomodim.

Çfarë parashikojnë ndryshimet në Ligjin për Turizmin?

Kryeministri Edi Rama tha se bumi turistik i këtij viti, përtej efekteve pozitive, e ka vënë qeverinë përpara disa sfidave, siç janë: siguria, ndotja dhe qasja në infrastrukturë. Ai tha se nuk mund të ndodhë që fitimet të shkojnë vetëm tek operatorët turistikë privatë dhe shteti të mos marrë atë që i takon, ndaj dhe do të ketë ndryshime në Ligjin për Turizmin. Sipas projektligjit të hedhur në konsultim, nga dhomat e thjeshta deri te vilat që akomodojnë pushues përmes platformave online, AirBNB apo Booking, dhe nuk kanë licencë, do të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Me këto ndryshime të propozuara synohet që strukturat informale që akomodojnë pushues, të futen në sistemin e deklarimit dhe të taksimit të të ardhurave.

Nëse nuk deklarohen do të ndëshkohen me gjobë nga 20 mijë lekë [190 euro] deri në 400 mijë lekë (3.700 euro). Gjoba është dyfishuar krahasuar me ligjin aktual.

Gjithashtu, parashikohet që të gjitha strukturat që do të ofrojnë shërbime akomodimi, ta kryejnë regjistrimin elektronik të klientëve me të dhënat përkatëse.

Të gjitha këto ndryshime, sipas Ministrisë së Turizmit, pritet t’i rrisin të ardhurat me 10-15 %, krahasuar me të ardhurat e këtij viti.

Çfarë thonë ekspertët?

Për ekspertin e ekonomisë në Shqipëri, Eduard Gjokutaj, shqetësim përbën “befasia”, sipas tij, me të cilën qeveria përpiqet ta prezantojë këtë projektligj. “Duhet të kishim një raport për çfarë ka konstatuar qeveria, pse është kjo nevojë dhe si e koncepton informalitetin ajo. Për mua, informaliteti nuk është problem i modifikimit të një ligji apo ndërhyrjeve të pjesshme. Lufta ndaj këtij fenomeni duhet të vinte nga një analizë. Momenti nuk është i përshtatshëm, pasi ka ende vizitorë”, thotë Gjokutaj.

Nga ana tjetër, shton ai, edhe statistikat çalojnë. “Deri në vitin 2019 statistikat kanë qenë më të specifikuar, dalloheshin vizitorët ditorë me ata që rrinin më gjatë. Tani mund të jenë edhe ata që vijnë si emigrantë dhe akomodohen në banesat e tyre”, thotë Gjokutaj.

Ekspertja tjetër e ekonomisë, Teuta Nunaj

Kortoçi, thotë se krahas fushatës që ka bërë qeveria për ta promovuar Shqipërinë, duhet të ishin marrë masa edhe për përbalimin e fluksit të pritshëm. Ajo thotë se prej se është miratuar ligji aktual, tetë vjet më parë, ka pasur zhvillime të vullshme, ndaj edhe masat duhet të ishin marrë më herët. “Institucionet veprojnë vetëm ‘post factum’, d.m.th. pasi ndodh ngjarja. Nuk marrin masa për ta parashikuar veprimin. Kjo i bën këto institucione të jenë me lëvizshmëri të ngadaltë dhe njëkohësisht hezituese e jokoherente me zhvillimin e tregut”, thotë Nunaj Kortoçi. “Matja e zhvillimit të turizmit vetëm me një tregues, siç është numri i turistëve, është e pamjaftueshme për ta identifikuar nivelin e zhvillimit të këtij sektori”, sipas saj. Nunaj Kortoçi shton se nuk mjafton vetëm ndryshimi i bazës ligjore, por edhe kontrolli i zbatimit të saj. “Është e rëndësishme që të zhvillohet edhe ndarja e kategorizimi i barrës fiskale sipas kategorive të turizmit, vendit dhe hapësirave. Sepse, një biznes p.sh. në Dhërmi apo Sarandë nuk mund ta ketë të njëjtin detyrim tatimor si ai në zonat më pak të zhvilluara. Në konsideratë duhet mbajtur edhe fakti se çdo ndryshim fiskal që mund të ndodhë në sektorin e turizmit, bizneset do ta përcjellin drejtpërdrejt te konsumatori final, duke rritur çmimin e shërbimit”, thotë Nunaj Kortoçi. Shqipëria, nga media të ndryshme ndërkombëtare, u radhit sivjet si një ndër destinacionet më interesante të sezonit veror 2023.

Lufta e Hamasit mbi Izraelin. Gjithçka që duhet të dini



Sulmi tronditës në jug të Izraelit këtë fundjavë ishte vrasja më masive e hebrenjve që nga Holokausti. Numri i të vdekurve është më i madh se në ditën më të keqe: Luftën e Yom Kipurit. Është një masakër që do të transformojë Izraelin dhe Lindjen e Mesme.

Çfarë ndodhi? Si u gjuhëzua fuqia ushtarake më e sofistikuar në Lindjen e Mesme? Dhe çfarë do të thotë kjo për shtetin hebre tani e tutje?

Por ka më shumë pyetje themelore. Ja disa pyetje që shpjegojnë se si arritëm këtu dhe ku mund të shkojmë.

Cila është përmasa e sulmeve? Dhe pse disa njerëz po e quajnë “11 shtatori i Izraelit”?

Mbi 700 izraelitë janë vrarë dhe më shumë se 2,100 janë plagosur në një seri sulmesh të befasishme e të koordinuara, që ndodhën brenda Izraelit. Sulmet nisën mëngjesin e të shtunës, 7 tetor. Sipas një zëdhënësi të FMI, rreth 1000 terroristë të Hamasit kaluan kufirin e njohur ndërkombëtarisht midis Gazës dhe Izraelit dhe filluan masakrimin e civilëve në të paktën 14 qytete dhe komunitete izraelite, duke hyrë në shtëpi dhe apartamente dhe duke vrarë burra, gra dhe fëmijë – duke përfshirë gati 300 të rinj që po merrnin pjesë në një festë muzike rave në shkretëtirë.

Skenat e tmerrit dhe gjakderdhjes, duke përfshirë vrasjet e familjeve të tëra, rrëmbimet e fëmijëve të vegjël dhe përdhunimet e grave të reja, me sa duket kishin për qëllim të shkaktonin zemërim dhe tronditje maksimale brenda Izraelit. Më shumë se 150 persona u kapën nga terroristët dhe u morën në Gaza, ku po mbahen peng. Ato përfshijnë gra, fëmijë shumë të vegjël dhe të moshuar. Për të dhënë një ide të shkallës së këtyre sulmeve, 700 të vdekur në një vend me 9.3 milionë banorë (ku të gjithë e njohin kushërinin e dikujt) është njësoj si një sulm terrorist në Amerikë, në të cilin mbi 25,000 njerëz do vriteshin brutalisht. Dhe jo në një katastrofë të vetme: imagjinoni 25,000 amerikanë të vrarë në skena të ndryshme në të gjithë vendin.

Kush i kreu këto sulme?

Hamasit është përgjigja e shkurtër, organizata terroriste që sundon Rripin e Gazës.

Hamasit nuk e njeh të drejtën e ekzistencës së Izraelit dhe ka zhvilluar atë që e quan një luftë rezistence që nga fillimi. Taktikat e tij gjatë viteve kanë evoluar nga rekrutimi dhe kryerja e sulmuesve vetëvrasës deri te lëshimi i breshërive të raketave. Por Hamasit kurrë më parë nuk kishte nisur një

operacion ushtarak të këtyre përmasave në Izrael.

Mirë, po a nuk ka Izraeli vendbanime në Gaza dhe a nuk kontrollojnë ata jetën e palestinezëve atje?

Izraeli u tërhoq në mënyrë të njëanshme nga çdo pëllëmbë e fundit e Gazës në vitin 2005, pasi çmontoi 21 vendbanimet izraelite që kishin ekzistuar në territor dhe ia dorëzoi ato Autoritetit Palestinez.

Arsyeja prapa tërheqjes së Izraelit, e zbatuar nga kryeministri Ariel Sharon, ishte ideja e “tokë për paqe” – që Izraeli do të dorëzonte kontrollin e territoreve të caktuara në këmbim të sigurisë. Toka u dorëzua. Paqja nuk erdhi kurrë.

Kjo ndodhi 18 vjet më parë. Hamasit ka sunduar vazhdimisht Rripin e Gazës që nga viti 2007, pas një konflikti ushtarak pesë-ditor me Autoritetin Palestinez, i cili urrehej gjerësisht nga banorët e Gazës, për korrupsionin e tij.

Që nga tërheqja e Izraelit, Hamasit ka iniciuar konflikte ushtarake në shkallë më të vogël me Izraelin në vitet 2006, 2008, 2011 dhe 2018, si dhe luftëra në shkallë të gjerë në 2008-09 (“Operacioni PLumbi i Derdhur”), 2012 (“Operacioni Kolonat e Mbrojtjes”), 2014 (“Operacioni Avantazhi Mbrojtës”) dhe 2021 (“Operacioni Ruajtësi i Mureve”).

Si mundënn terroristët e armatosur me “Jeep-a” të kalonin gardhin kufitar miliarda dollarësh të Izraelit dhe të masakronin qindra civilë, të merrnin pengje dhe t’i merrnin me vete në Gaza? A nuk supozohet që ushtria izraelite të jetë e mirë në këto gjëra?

Pyetje e shkëlqyer. Para së gjithash, koha është e rëndësishme. Sulmet ndodhën gjatë festës së Sukkot, kur shumë ushtarë u dërguan në shtëpi për të qenë me familjet e tyre. Njësi të tjera që ishin zakonisht në të ashtuquajturin “Zarf i Gazës” – pjesa e Izraelit që kalon përgjatë Rripit të Gazës – ishin zhvendosur në Bregun Perëndimor, me qëllim që të mbroheshin izraelitët që jetojnë në Jerusalem dhe në komunitetet e Bregut Perëndimor nga sulmet gjatë festës.

Por kjo nuk shpjegon se si Izraeli, një nga vendet më të përparuara në planet – me disa nga teknologjitë më të sofistikuar të mbikëqyrjes, shumë prej të cilave i shpikën dhe i zhvilluan vetë posaçërisht për këto qëllime – u zu në befasi.

Sipas burimeve në Izrael dhe Amerikë që merren me sigurinë kombëtare dhe teknologjinë, një skenar i mundshëm përfshinte një sulm kibernetik që rrëzoi gardhin kufitar të Izraelit, me shtresat e tij të sensorëve, herët në

mëngjesin e së shtunës, 7 tetor. Sulmi mendohet se ka prekur pjesë të sistemit Iron Dome që mbrojnë civilët izraelitë nga sulmet e shpeshta me raketa nga fqinjët e tyre në Rripin e Gazës.

Duket gjithashtu e mundshme, siç shpjegoi eksperti i sigurisë Eduard Lutvak në Tablet, që shërbimet e shumëlëvduara të sigurisë të Izraelit u mashtruan nga operativë brenda Rripit, të cilët kanë qenë në partneritet të fshehtë me Izraelin gjatë viteve të fundit, për të transmetuar informacione rreth sulmeve me raketa nga rivali i Hamasit brenda Gazës, grupi terrorist Xihadi Islamik i mbështetur nga Irani. Ndërsa izraelitët u mbështetën te njerëzit që mendonin se ishin partnerë të tyre, ata filluan të imagjinonin se mund të menaxhonin në heshtje Hamasin duke rritur tregtinë me Rripin, duke lejuar më shumë mallra, duke lejuar banorët e Gazës të hynin në Izrael për trajtim mjekësor falas dhe duke lëshuar leje pune, që banorët e Gazës të punojnë brenda Izraelit, ku të ardhurat e një muaji mund të ushqejnë një familje nga Gaza për një vit.

Që nga viti i kaluar, Izraeli ka lëshuar mbi 15,000 leje të reja pune për banorët e Gazës për të punuar në Izrael, duke besuar se ky gjest humanitar do të gjente reciprocitet



tek Hamasi. Gaboheshin.

Në përgjithësi, një nga gjërat më të habitshme dhe të tmerrshme në lidhje me sulmet për izraelitët dhe për vëzhguesit e jashtëm, është se pasi terroristët kishin kaluar kufirin, ata dukej se nuk ndeshën në rezistencë dhe thjesht ishin në gjendje të kalonin me makinë nëpër zona të gjera të Izraelit, e të kryenin vrasje sipas dëshirës. Nga pikëpamja e sigurisë, është e qartë se nuk ka asnjë zëvendësues për njerëzit e trajnuar mirë me armë. Një nga mësimet e kësaj dite të tmerrshme në historinë e Izraelit ka të ngjarë të jetë se, besimi i vendit se teknologjia është çelësi për zgjidhjen e problemeve të tij dhe mbrojtjen e qytetarëve të tij, është i tepruar.

Një grup terroristësh të nivelit të ulët me kamionçina, arritën t'i bënëin të gjitha këto vetë?

Jo!

Ky ishte një sulm iranian i kryer nga terroristët e Hamasit. Irani është furnizuesi kryesor i armëve dhe mbështetësi politik i Hamasit (i cili mbështetet edhe nga Turqia). Siç raportoi dje Wall Street Journal, organizimi dhe planifikimi për sulmin erdhi drejtpërdrejt nga regjimi iranian dhe u finalizua në një takim të hënën e kaluar në Bejrut.

Bejruti? Kjo në fakt është e rëndësishme. Irani mbështet Hamasin si pjesë e "Boshtit të Rezistencës", e cila është një aleancë ombrellë e personazheve më të këqij të rajonit – duke përfshirë kasapin Bashar al-Assad në Siri, i cili vrau më shumë se gjysmë milioni njerëz nga populli i tij; Hezbollahu, grupi terrorist që tani drejton Libanin; militantët në Irak; dhe ushtria fisnore Houthis që ka copëtuar Jemenin.

Gjatë dy dekadave të fundit, Irani filloi të pozicionojë Boshtin e Rezistencës si një mënyrë për të dominuar rajonin. Ai gjeti një vesh të hapur te Barack Obama, i cili po kërkonte të hapte rrugën për një dalje të shpejtë amerikane nga Iraku – dhe nga ngatërime të tjera

rajonale që mund ta çonin Amerikën në një luftë tjetër vdekjeprurëse dhe të pakuptimtë në Lindjen e Mesme. Obama besonte se iranianët ishin e vetmja fuqi për të drejtuar rajonin pa ndihmën amerikane. Tani e shohim se sa mirë doli.

Pse ndodhi tani sulmi? A nuk po ecnin drejt paqes, Izraeli dhe Arabia Saudite?

Pikërisht.

Ajo që ndodhi më së fundi ishte se filloi të merrte formë një marrëveshje paqeje saudio-izraelite – e cila do të kishte ofruar një kundërpeshë potencialisht të fuqishme ndaj ambicieve të Iranit për hegjemoni rajonale. Iranianët nuk e pëlqejnë këtë.

Mendimi i Iranit duket se ka qenë që, nëse sulmi i Hamasit do të ishte brutal dhe mjaft vdekjeprurës, izraelitët nuk do të kishin zgjidhje tjetër veçse të sulmonin ashpër në Gaza, duke prodhuar mijëra fotografi dhe video të ndërtesave të shkatërruara, trupave të vdekur dhe fëmijëve që qanin. Kjo do të ndizte të ashtuquajturën "Ruga Arabe", duke e bërë të pamundur për sauditët që të bashkohen publikisht me Izraelin dhe duke e lënë Iranin nën kontrollin e rajonit. Pra, nëse ka pasur, me të vërtetë, një sulm kibernetik, kush e kreu?

"Do të duhej një hackerim i sistemeve të shumta të Mbrojtjes Izraelite, në mënyrë që të shihnim atë që pamë," tha një burim. "Gardhi i Gazës është ndërtuar për të qenë një nga barrierat më të sofistikuar të krijuara ndonjëherë, dhe megjithatë ata ishin në gjendje ta shkelin atë në zona të shumta, para se dikush të kishte mundësinë të ngruhej nga shtrati". Nuk ka aq shumë aktorë që mund ta kishin realizuar këtë vetë. Iranianët janë padyshim të përfshirë dhe do të donin të merrnin edhe më shumë merita sesa kanë tashmë, por sulmet kibernetike iraniane ndaj sistemeve izraelite janë të vazhdueshme dhe rrallëherë shumë të suksesshme. Rusia

gjithashtu ka kuptim si një faktor, në kontekstin e partneritetit të tyre gjithnjë e më të ngushtë me Iranin për të çuar më tej luftën në Ukrainë dhe tensionet që ka shkaktuar lufta në marrëdhëniet Rusi-Izrael.

Megjithatë, kontributi në një masakër në shkallë të gjerë të civilëve izraelitë do të ishte një veprim fatal. Ekziston edhe fakti se Rusia në përgjithësi është mjaft e ndjeshme për financimin e grupeve terroriste islamike, pas luftërave që ajo zhvilloi në Çeçeni dhe Dagestan.

Mund të ishte Kina, pasi çmontimi i sistemeve mbrojtëse të Izraelit me shtypjen e një butoni do t'i dërgonte një mesazh të fuqishëm Tajvanit dhe vendeve të tjera aziatike, që kanë blerë sisteme mbrojtëse nga SHBA-të dhe blejnë sasi të mëdha naftë iraniane. Por për çfarë i duhet Kinës kjo? Ata kanë problemet e tyre me radikalizmin islamik, të cilin e shtypin në shtëpi me grusht të hekurt.

Në fund, janë amerikanët. Siç tregon nxjerrja e postës elektronike javën e kaluar në lidhje me kryediplomatën amerikan Robert Malley, afrimi i SHBA me Iranin ka përfshirë më shumë sesa përpjekjen për të negociuar një marrëveshje bërthamore. Ka përfshirë gjithashtu gjetjen e njerëzve, shumë prej tyre iranianë të gjeneratës së parë ose të dytë, të cilët mund të shërbejnë si ndërmjetës në negociatë. A ishin në fakt disa nga ata ndërmjetës duke marrë orientime nga Irani? Po, ishin. Por edhe nëse kjo do të ndodhte, nuk ishte politika e SHBA. Ishte më shumë si spiunazh armiqësor.

Në fund, përgjigja është mjaft e thjeshtë: E bëri Hamasi.

Çfarë duhet të bëjnë izraelitët tani?

Në një univers të përsosur, izraelitët do të duhej të ishin në

gjendje të kujdeseshin për familjet e të vdekurve dhe të plagosurve të tyre, ndërsa do të merrnin të gjithë pengjet e padëmtuara, dhe më pas do të firmosnin një traktat paqeje me Arabinë Saudite që do të kundërbalancoonte boshtin iranian të terrorit dhe do të siguronte të gjithë rajonin. Fatkeqësisht, asgjë nga këto nuk do të ndodhë.

Në logjikën mizore të rajonit ku ndodhet Izraeli, vrasjet e Hamasit nuk ishin një shembull i neveritshëm i thellësive të barbarizmit njerëzor. Ajo ishte një fitore e madhe që bëri copë mbrojtjen e lavdëruar ushtarake të Izraelit. Miliona arabë dhe banorë të tjerë të Lindjes së Mesme, të ngecur në vendet e varfra të udhëhequra nga regjime jofunksionale dhe shtypëse, mund të shkojnë në shtrat natën me një rreze shprese: Izraeli mund dhe do të shkatërrohet. Një luftë rajonale vështirë se është e pamundur, përveç nëse Izraeli mund të rivendosë fuqinë e tij parandaluese shpejt dhe të provojë se nuk është një tigër letre. Kjo do të thotë luftë.

Po luftë me kë? Mjerisht, marrëveshja e Amerikës me Iranin dikton përgjigjen edhe atje. Izraeli vështirë se mund t'i kundërpërgjigjet Iranit, edhe sikur të donte, sepse Irani tani është nën mbrojtjen e Shteteve të Bashkuara, të cilat ushqejnë regjimin me dërgesa të rregullta parash dhe kanë premtuar të mbrojnë programin e tij bërthamor.

Një sulm izraelit në vendburimet e naftës të Iranit, ose një goditje ndaj programit bërthamor të Iranit, ose prerja e kokave të regjimit iranian, ka të ngjarë të jetë mirë për Izraelin dhe mirë për rajonin. Por duke qenë se ato do të ishin në fakt goditje kundër rendit rajonal që u krijua dhe mbështetet nga Shtetet e Bashkuara, goditja e Iranit do ta vendoste Izraelin në konflikt të

drejtpërdrejtë me Shtetet e Bashkuara. Ky është një rrezik shumë i madh për një Izrael të ndarë dhe të traumatizuar.

Izraeli mund të godasë edhe aleatin strategjik më të vlefshëm të Iranit, që është Hezbollahu, grupi terrorist që kontrollon Libanin. Megjithatë, meqenëse Hezbollahu nuk e sulmoi Izraelin dhe nuk duket se ka pasur ndonjë përfshirje të drejtpërdrejtë në sulme, një veprim i tillë do të ishte më i vështirë për t'u justifikuar – dhe do të përfshinte Izraelin në një luftë dy frontesh me një kundërshtar shumë më të fuqishëm sesa Hamasi.

Prandaj Izraeli do të jetë i detyruar të bëjë diçka në Gaza, megjithëse duart i ka të lidhura edhe atje, nga mbi 150 pengje që mori Hamasi, shumë prej të cilëve thuhet se janë amerikanë. Kjo do të thotë se rezultati i çdo gjëje që Izraeli bën ka të ngjarë të jetë po aq i pakuptimtë sa luftërat e tij të mëparshme në Gaza, të cilat lanë Hamasin në krye të Gazës.

Ajo që është e qartë nga e gjithë kjo është se strategjia frenuese e Izraelit me shkopinj, karota dhe barrierë elektronike kundër Hamasit ka dështuar dhe diçka e re do të duhet të provohet.

Po çfarë ndodh me palestinezët në Gaza? A nuk po vuajnë ata?

Po. Palestinezët e zakonshëm po vuajnë çdo ditë nën sundimin brutal të Hamasit. Por vrasja e gjysheve dhe ngarkimi i trupave të tyre të pajetë në faqet e tyre në Facebook që familja e tyre t'i shohë dhe masakrimi i njerëzve në një festival muzikor nuk janë veprime të ndërmarra nga njerëzit që kërkojnë të ndërtojnë ose luftojnë për një shoqëri të lulëzuar. Dhe kushdo që insiston ta bëjë këtë pyetje në një fundjavë kur më shumë se 700 civilë u vranë, gra u përdhunuan dhe foshnja u rrëmbyen, ka një paaftësi të theksuar për të pranuar vuajtjet e të tjerëve. / The Free Press – Bota.al

Martin Scorsese ka frikë për të ardhmen e kinemasë!



Nga: Tom BROOK / BBC

Në prag të premierës së dramës së tij të re epike, të krimimit uestern *Killers of the Flower Moon*, regjisori i madh amerikan, Martin Scorsese, rri ulur me mua në një suitë hoteli me pamje nga Central-Parku i Nju-Jorkut – duke vajtuar për gjendjen e filmave bashkëkohorë të Hollivudit. Në një intervistë të gjatë për programin *Talking Movies* të BBC-së, për valën aktuale të serive të suksesshme filmike, ai thotë: “Nuk janë për mua ... teksa po plakem, përpiqem të kuptoj se ku drejtim do ta kaloj kohën time. Nuk mund ta kaloj me ata filma”.

Kjo ndjesi është në përputhje me intervistën, shpeshherë të cituar, që ai dha katër vjet më parë për *Empire Magazine*, në të cilën deklaroi se filmat e superheronjve të Marvel-it u ngjanin “parqeve tematike” dhe se “nuk ishin kinematografi”.

Sot, duke më folur për programin *Talking Movies* të BBC-së, me dëshpërim kujton të kaluarën kur studiot e mëdha ia dëllnin me “punë serioze, madje edhe me komedi serioze. Ajo që po them është se paratë tashti shkojnë për seritë, për filmin aksion, dhe ato aty do të qëndrojnë”. Po ashtu, thotë se filmat e sotëm indi, ku forma e artit vazhdon të lulëzojë, nuk arrijnë te platformat ku e meritojnë të jenë: “I duam ata më të mëdhenjtë. Duam më shumë audiencë për t'i parë”, thotë ai.

Në fakt, Scorsese kurrë nuk ka qenë lojtar i madh në sistemin e studiove, por *Killers of the Flower Moon* është shembull i rrallë i “punës serioze” me buxhet të

madh – diçka që sot është zhdukur. Është përshtatje epike, në tri orë e gjysmë, e librit të David Grannit, *Killers of the Flower Moon: The Osage Murders and the Birth of the FBI* – me protagonistët e Scorseseit si Robert De Niro dhe Leonardo DiCaprio. Flet për vrasjet e shumë anëtarëve të komunitetit indigjen në Oklahomën e viteve 1920, gjë që paraqet të ashtuquajturin “Mbretërim i Terrorit” ku më shumë se 60 amerikanë vendas u vranë nga ndërhyrësit e bardhë që përpiqeshin t'i shtrinin duart te nafta që shtrihej poshtë tokës Osejxh [Osage].

Është uesterni i parë i Scorseseit, por është gjithashtu një dramë krimi, vula e tij, dhe sigurisht që paraqet burrat maço dhe dhunën që prej kohësh kanë identifikuar veprat e tij. Filmat e tij të mëparshëm, duke u fokusuar ndër të tjerash te *Gangsterët* e Nju-Jorkut, ishin histori personazhesh me motive jo shumë të ndryshme nga ato të biznesmenëve të paskrupullt në *Killers of the Flower Moon*.

Siç shpjegon: “U rrita në një zonë të krimimit në rrugë, të krimimit të organizuar, me shumë njerëz që bënin gjëra të këqija. Kështu që, në këtë histori mund të tërhiqesh nga grabitja e dyqanit të dikujt e ta çosh në pikën e torturimit të një kombi, të një kombi autokton”.

Këto ditë, shumë filma të suksesshëm të Hollivudit, veçanërisht filmat me vazhdime, nuk arrijnë të ofrojnë ndonjë tregim të veçantë. Edhe pse Scorsese ka qenë ndonjëherë regjisor që merret “me qira”, zakonisht ka bërë filma sipas kushteve të veta, filma që

pasqyrojnë talentin e tij. E vlerëson kinemanë në të cilën mbizotëron vizioni artistik i kineastit.

Duket se ia doli me *Killers of the Flower Moon*. Thuhet se është financiar në vlerën e rreth 200 milionë dollarëve, nga Apple Original Films, por regjisori pohon se ka mbetur pak a shumë si i vetëm. “Mund të thuash, ‘Epo, kjo është për shkak se ti je ai që je, por po, unë jam 80 vjeç tani’. Kështu që ia dola ta bëj një film ku askush nuk më rrinte mbi supë... nëse po, ishin shumë të qetë”, thotë ai. Scorsese zë një vend të rrallë në kinemanë amerikane – si regjisor që bën filma epikë në mënyrën e vet. Kohët e fundit, Christopher Nolan me *Oppenheimer* dhe Greta Gerwig me *Barbie*, triumfuan me filma me buxhet të madh, të cilët – si ai i Scorseseit – mbanin vulën personale të regjisorës. Por, paraqesin një përjashtim.

Tetëdhjetëvjeçari Scorsese e di se ai dhe kineastët e tjerë po përballen me një peizazh të ndryshuar, ku vizitat në kinema nuk janë kthyer në nivelet që ishin para koronavirusit. Edhe kur bëhet fjalë për shfaqjen e filmave të tij në ShBA, ai duhet të përballlet me publikun që është më shumë se kurrë i ndarë dhe i polarizuar në aspektin politik. Gjithashtu, në një epokë ku ka vërejtje më të mëdha se kush paraqitet në ekran dhe si, Scorsese duhet të kishte kujdes të shtuar për të rrëfyer një histori – si ajo e vrasjeve në Osejxh. Ishte i vendosur që *Killers of the Flower Moon* t'ua jepte peshën e duhur personazheve indigjene – dhe, në fakt, epika e tij nuk u përket burrave të bardhë të luajtur nga Robert De Niro dhe Leonardo

DiCaprio, por një gruaje vendase amerikane të portretizuar nga Lily Gladstone.

Performanca e Gladstoneit është një nga pikat kryesore të debateve për këtë film. Scorsese e ka parë atë në filmin dramatik të Kelly Reichardit të vitit 2016, *Certain Woman*. “E pashë atë fytyrë dhe pashë se çfarë ndodhte me sytë e saj dhe thashë ‘Kjo është ajo; është interesante’”, kujton për ndikimin që pati tek ai. Në garën në zhvillim për çmimet Oscar, Gladstone po bën fushatë për t'u bërë interpretuesja e parë indigjene që do të nominohet për çmimin për Aktoren më të Mirë.

Edhe pse Scorsese ka reputacion të jashtëzakonshëm, nuk ka asnjë garanci që *Killers of the Flower Moon* do të ketë sukses material. Në kulmin e viteve 1970 të regjisorit, filmat si *The Godfather* ishin në gjendje të bashkonin audiencën anembanë globit. Scorsese dyshon nëse kinemaja ka ende të njëjtën fuqi për ta bërë audiencën bashkë.

“Nuk jam i sigurt, shpresoj se mundet”, thotë ai. “Mund ta kem gabim për këtë, por problemi është se [peizazhi i filmit] është i fragmentuar. Filmat bëhen për një grup të caktuar ... keni filma për grupe të ndryshme të gjinive të ndryshme, të seksualiteteve të ndryshme etj. Duhet të jenë filma, të gjithë ata”.

Me filmat që nuk kanë fat të sigurt për shikueshmëri, Scorsese ka investuar më shumë se kurrë në ruajtjen e historisë së celuloidit dhe rikthimit të tij. Në vitin 1990, ndihmoi në krijimin e *The Film Foundation*, si organizatë e dedikuar për ruajtjen e shiritit filmik; që nga themelimi është

përfshirë në restaurimin e më shumë se një mijë veprave. Ndër triumfet e tij të fundit është restaurimi, në Arkivin Kombëtar të BFI-së, i filmit *Pressure* – filmit të parë artistik me përvoja të të zinjeve të Britanisë, që u publikua më 1976 me regji nga Sir Horace Ove që vdiq muajin e kaluar. Premiera botërore e filmit të restauruar do të jepet në Festivalin e Filmit në Londër dhe në Nju-Jork më 11 tetor.

Duke krahasuar filmat e vjetër me librat e lashtë, Scorsese beson se duhet të ruhen. “Pamja që na jep... [] përfaqësimi i asaj se kush jemi apo kush ishim, si kemi ndryshuar, gjërat e mira, gjërat e turpshme – këto nuk mund të fshihen nën qilim”.

Scorsese mbush 81 vjet në nëntor dhe ka filma që ai ende do të dëshiron të t'i bënte. Duke u përcaktuar se ku do t'i përqendrojë energjitë e veta, kujton këshillën e regjisorit legjendar iranian Abbas Kiarostami: “Më shikoi dhe më tha: ‘Mos bëj asgjë që nuk dëshiron të bësh. Thjesht mos e bëj’. Dhe, e di se çfarë donte të thoshte”.

Në fakt, filmin e ditëve të sotme, regjisori veteran e shikon në aspektin pragmatik. “Varet nga ajo që ka në kornizë, ku ta vendosni atë aparat fotografik dhe ku ta kaloni kohën që ju ka mbetur duke e treguar një histori. A vlen për ju”? Shumica e vlerësimeve për *Killers of the Flower Moon*, kanë gjykuar se është histori që ia vlen të tregohet. Kritiku Pete Hammond, nga *Deadline*, shkoi aq larg sa e quajti “arritje të rëndësishme të filmit” dhe ky është verdikti me të cilin shumë do të pajtoheshin – dhurata e fundit në karrierën e tij si një prej kineastëve më të shquar amerikanë. //Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Pezullohet ndeshja e Trepçës në Izrael

MITROVICË, 10 TETOR - FIBA Evropa ka njoftuar se të gjitha ndeshjet e skuadrave izraelite në garat evropiane janë pezulluar për momentin për shkak të situatës në Izrael. Kështu është pezulluar për momentin edhe sfida Hapoel Galil Elion-Trepça, e planifikuar

të zhvillohej më 18 tetor. "Duke pasur parasysh situatën aktuale të sigurisë në Izrael dhe pas rekomandimit të këshilltarëve të saj të sigurisë, FIBA Evropa mori vendimin për t'i pezulluar të gjitha ndeshjet që përfshijnë ekipet izraelite. Vendimi vlen për të gjitha garat e FIBA

Evropës dhe është në fuqi deri në një njoftim tjetër", thuhet në njoftimin e FIBA-s. Janë pesë skuadra nga Izraeli që paraqiten në FIBA Europe Cup dhe në EuroCup Women. Trepça është në grup me Hapoel Galil Elion nga Izraeli, ZZ Leiden nga Holanda dhe

Gravelines Dunkerque nga Franca. Përballja e parë dhe historike për klubin mitrovicës do të jetë kundër ZZ Leiden nga Holanda më 25 tetor në "Minatori". Kjo është hera e parë që "Xehetarët" janë pjesëmarrës të grupeve në FIBA Europe Cup. Në grupe do



të luajë edhe kampionia e Kosovës, Peja.

Rrahmani dhe Zyba: Ndaj Andorrës luajmë për fitore

"Dardanët" kanë përfunduar stërvitjen e fundit para se të udhëtojnë drejt Andorrës, derisa futbollistët Albion Rrahmani dhe Qëndrim Zyba kanë paralajmëruar se Kosova nga kjo ndeshje synon fitoren e parë në kualifikimet për "Euro 2024"

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 10 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të martën e ka zhvilluar seancën e dytë stërvitore dhe të fundit në Kosovë në kuadër të përgatitjeve për ndeshjen kundër Andorrës. "Dardanët" të enjten përballen me Andorrën nga ora 20:45 në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2024". Sulmuesi Albion Rrahmani ka thënë se "dardanët" synojnë rezultat pozitiv nga kjo

ndeshje, derisa nuk ka hezitur të japë edhe një premtim të madh se do të japë shpirtin në fushë për ta arritur synimin. "Gjendja e ekipit është jashtëzakonisht e mirë. Shpresoj se të gjithë bashkëlojtarët të jenë në fizikun 100 për qind. Na pret një ndeshje e vështirë, por besoj se me kualitetin që kemi do të marrim rezultatin pozitiv, pse jo tri pikë. Është ndjenjë e veçantë ta kesh barrën kryesore të kombëtarja, të cilën e kam ëndërruar me vite që të jem pjesë e saj. Jam shumë



krenar që tashmë do të kem hapësirë që ta ndihmoj kombëtaren. Besoj që në këtë ndeshje të shënoj dhe ta ndihmoj ekipin. Shpresoj që gjithçka të shkojë mirë. Unë do ta lë shpirtin në fushë për këtë fanellë, sepse është nder dhe krenari ta kesh në trup", ka thënë Albion Rrahmani.

Sulmuesi i Rapid Bukureshtit pritet të jetë titullar pas mungesës së Vedat Muriqit. Për këtë ndeshje foli edhe mesfushori i Ballkanit, Qëndrim Zyba, i cili është ftuar për herë të parë në përfaqësuese. Zyba ka bërë me dije se tash po i realizohet ëndrra që e ka pasur nga fëmijëria për të luajtur për

Kosovën, kurse sa iu përket synimeve, ai bëri me dije se "dardanët" do të luajnë për fitore. "Me të vërtetë është një prej ëndrrave që kam pasur që nga fëmijëria dhe më është realizuar. Çdo moment që i duhemi shtetit tonë jemi në gjendje për të dhënë më të mirën tonë. Falë Zotit jam në formë mjaft të mirë dhe shpresoj që atë që di të bëj më së miri ta ndihmoj ekipin nëse më jepet mundësia. Djemtë janë të shkëlqyeshëm. Ata na kanë pritur shumë mirë neve që jemi më të rinj dhe i falënderoj shumë sepse na kanë afuar shumë shpejt në grup. Andorra? Çdo kundërshtar është i vështirë, por ne do ta japim maksimumin dhe do t'i bëjmë detyrat që na cakton trajneri. Patjetër duhet të shkojmë për fitore", ka thënë Zyba.

Thaqi emërohet trajner i FC Suhareka

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

SUHAREKË, 10 TETOR - Skuadra e Ligës së Parë, Suhareka, e ka emëruar Arsim Thaqin në pozitën e trajnerit. Ky klub një ditë më parë e shkarkoi nga detyra e trajnerit Granit Begollin. "Kemi arritur marrëveshje me timonierin e ri të skuadrës sonë, Arsim Thaqi, i cili do ta vazhdojë rrugëtimin tonë drejt sukseseve dhe objektivave të klubit. Thaqi u prezantua nga i pari i klubit, Rustem Aliaj dhe aksionarët e klubit. Një emër i njohur i futbollit kosovar i cili ka udhëhequr skuadra me renome e mjaft të forta si FC Prishtina, FC



Drita, KF Malisheva", thuhet në njoftimin e skuadrës së Suharekës. Të mërkurën klubi do të udhëtojë

për në Shqipëri për një mini-fazë përgatitore e cila, përveç skuadrës, do ta ndihmojë edhe trajnerin e ri në njohje me futbollistët. Pas emërimit të Thaqit në krye të klubit ka reaguar edhe presidenti i FC Suhareka, Rustem Aliaj, i cili e falënderoi ish-trajnerin Begolli, derisa ka bërë me dije se i ka kërkuar trajnerit të ri, Arsim Thaqi, të krijojë një grup me karakter fitues të disiplinuar dhe korrekt e lojëra në frymë sportive. "Duke e falënderuar ish-trajnerin Begolli, në praninë e drejtuesve dhe futbollistëve të FC Suhareka kemi prezantuar trajnerin e ri Arsim Thaqi, një trajner tashmë i mirënjohur. Natyrisht koha është

ari, ndaj nuk kemi lejuar vetes luks të vazhdojmë pa trajner, prandaj kemi bërë zgjedhjen e shpejtë, por gjithsesi të duhur. Si gjithnjë trajnerit të ri i kam dëshiruar mirëseardhje dhe i kam kërkuar veç angazhimit të tij profesional, të krijojë një grup me karakter fitues të disiplinuar dhe korrekt e lojëra në frymë sportive. Nga ana e tij Thaqi ka falënderuar për besimin që i kemi dhënë duke na premtuar punë, angazhim që t'i përmbushim synimet e klubit. Në emër të futbollistëve e kam falënderuar dhe dëshiruar mirëseardhje trajnerit të ri. Trajnerin e ri dhe FC Suhareka e presin sfidat e reja në vazhdim të garave", ka thënë Aliaj.

Mirlind Daku takohet me bashkëshorten e Agim Ramadanit, ia dhuron fanellën e Kombëtares

TIRANË, 10 TETOR - Mirlind Daku ka pasur një vizitor shumë të veçantë në grumbullimin me Kombëtaren e Shqipërisë. Sulmuesin gjilanas e ka vizituar bashkëshortja e komandantit legjendar të

UÇK-së, Agim Ramadanit. Daku kishte shënuar gol ndaj Polonisë dhe kishte zhveshur fanellën ku në shpinë e ka tatuazhin e kufirit të thyer nga komandanti legjendar Agim Ramadani. Në një lidhje televizive në mes të

Dakut dhe Shukrije Ramadanit, sulmuesi gjilanas e kishte ftuar atë ta vizitonte. Tani ajo e ka vizituar dhe ka marrë dhuratë fanellën dhe është takuar edhe me futbollistët e tjerë të Shqipërisë. "Takim i

këndshëm me Mirlind Dakun dhe sportistët që na bëjnë krenarë! Në kombëtare nuk ka kufij, aty kemi Shqipërinë etnike! Ju lumtë djema! Ju priftë e mbara e suksesi", ka shkruar Shukrije Ramadani në "Facebook".



UEFA zgjedh vendet mikpritëse për 'Euro 2028' dhe 'Euro 2032'

NIJON, 10 TETOR - UEFA ka konfirmuar zyrtarisht të martën se Kampionati Evropian i vitit 2028 do të organizohet nga Mbretëria e Bashkuar dhe Republika e Irlandës, ndërsa "Euro 2032" nga Italia dhe Turqia në një kandidaturë të përbashkët. Në

mbledhjen e mbajtur në selinë e UEFA-s në Zvicër, Komiteti Ekzekutiv i UEFA-s ka caktuar federatat pritëse për "Euro 2028" dhe "Euro 2032". Kështu, organizimin e "Euro 2028" e kanë fituar Mbretëria e Bashkuar dhe Republika e Irlandës. "Euro 2028" do të

zhvillohet në Mbretërinë e Bashkuar dhe Republikën e Irlandës! Vendet e propozuara përfshijnë Belfast, Birmingham, Cardiff, Dublin, Glasgow, Liverpool, Londër (x2) Manchester dhe Newcastle", thuhet në njoftimin e UEFA-s. Përveç

kësaj, UEFA konfirmoi gjithashtu se kandidatura e përbashkët e Italisë dhe Turqisë ka fituar organizimin e "Euro 2032". "Urime Italisë dhe Turqisë, bashkë-pritëse të 'Euro 2032'! Ofertuesit e përbashkët prezantuan 20 stadione të mundshme



pritëse, nga të cilat 10 do të zgjidhen, pesë për shtet, deri në tetor 2026", thuhet në njoftim.

De Biasi: Skuadra aktuale e Shqipërisë është më e mirë se ajo që iku në Francë

TIRANË, 10 TETOR - Kur Kombëtarja e Shqipërisë në futboll shkroi historinë në vitin 2016 duke u kualifikuar për herë të parë në Kampionatin Evropian "Euro 2016", pjesë e suksesit ishte edhe trajneri italian Gianni De Biasi, i cili tashmë e drejton Kombëtaren e Azerbajxhanit. Ky emër u bë trajneri i parë që udhëhoqi Shqipërinë drejt një kampionati madhor siç ishte Evropiani. Suksesin e De Biasit, "kuqezinjtë" janë afër ta arrijnë edhe këtë vit me brazilianin Sylvinho. Shqipëria është afër ta sigurojë një "biletë" që dërgon në Evropianin që organizohet në Gjermani verën e ardhshme. De Biasi, tani 67-vjeçar, ka rrëfyer në një intervistë për lajmi.net. Aventura tek Azerbajxhani, vlerësimi për kombëtaren e tanishme të Shqipërisë, dallimin mes skuadrës që dikur drejtoi ai te Shqipëria dhe kësaj që tani e drejton Sylvinho. "Jam i lumtur për rezultatet e kombëtares shqiptare. Unë mbeta shqiptar jo vetëm për pasaportën, por për historinë shkëlqyer që përjetuam të gjithë së bashku. Rezultatet nuk vijnë rastësisht, por bëhet



një punë e madhe nga Federata dhe teknikët. Unë shpresoj dhe besoj që Shqipëria të kualifikohet në Evropianin e vitit të ardhshëm në Gjermani. Në fakt, nuk ka asnjë dyshim për këtë. Ndeshja kyçe do të jetë me Çekinë, më pas rruga është e hapur ndaj Moldavisë dhe Ishujve Faroe. Mendoj se Shqipëria i ka të gjitha mundësitë për të dalë e para në grup", ka thënë De Biasi. "Nuk është e lehtë ta krahasosh realitetin e dy ekipeve, atij që drejtova unë kur shkuam në Evropianin e Francës dhe këtij të

sotmit. Skuadra e sotme ka më shumë lojtarë cilësorë, me përvojë të rëndësishme ndërkombëtare në klube të mëdha. Ky është aspekti kryesor që i jep kualitet këtij ekipi. Kur isha unë, kishim pak lojtarë që luanin në klube të rëndësishme. Kur mbërrita në Shqipëri vetëm Lorik Cana luante në Serinë A. Më pas mbërritën Hysaj, Etrit Berisha, Migjen Basha te Torino. Pjesa tjetër ishin lojtarë që luanin në kampionet si Zvicra dhe asgjë më shumë", ka deklaruar De Biasi.

Hazardi pensionohet nga futbollit

MADRID, 10 TETOR - Eden Hazardi ka njoftuar tërheqjen e tij nga futbollit në moshën 32-vjeçare. Futbollisti belg nënshkroi për Real Madridin në një marrëveshje prej 150 milionë funtesh nga Chelsea katër vjet më parë, por karriera e tij në La Liga nuk pati ndikimin që pritej për shkak të lëndimeve. Hazardi bëri vetëm 76 paraqitje për "Los Blancos" duke shënuar shtatë gola. Këto shifra e zbehën karrierën e Hazardit i cili me Chelsea u shndërrua ndër lojtarët më të mirë në historinë e londinezëve. Ish-anëtar i Lilles shënoi 110 gola në 352 ndeshje për "Blutë" nga 2012-19, duke luajtur një rol



kryesor në dy rrugëtimet drejt titullit kampion në Premierë Ligë. "Duhet ta dëgjosh veten dhe të thuash 'mjaft' në kohën e duhur. Pas 16 vjetësh dhe më shumë se 700 ndeshjesh të luajtura, kam vendosur ta mbyll karrierën time si futbollist profesionist. Isha në gjendje ta realizoja ëndrrën time

dhe kam luajtur dhe jam zbatimur në shumë fusha dhe stadione përreth botës", ka shkruar Hazard në "Instagram". "Gjatë karrierës sime isha me fat të takoja trajnerë, menaxherë e bashkëlojtarë të mëdhenj. Faleminderit të gjithëve për çdo gjë për këto kohëra të arta, do të më mungoni shumë. Dua t'i falënderoj krejt klubet ku kam luajtur: LOSC, Chelsea e Real Madrid. Dua ta falënderoj edhe Federatën Belge të Futbollit për paraqitjen time në Kombëtaren e Belgjikës. Një falënderim special për familjen time, për miqtë, këshilltarët dhe për njerëzit që ishin afër meje në kohë të mira dhe të këqija", ka deklaruar Hazardi.

Jesus: Nuk është e lehtë të triumfosh ndaj Cityt

Arsenali pas plot tetë vitesh arriti ta mund Manchester Cityn në "Emirates Stadium", me rezultat 1-0. Për këtë fitore tejet të rëndësishme foli dhe braziliani tjetër i sulmit, Gabriel Jesus, me 26-vjeçarin

që e quan një fitore të madhe suksesin në "Emirates" ndaj "qytetarëve" të Manchester Cityt. "Sigurisht që është një fitore e madhe. Të gjithë e dinë se sa e vështirë është të luash kundër tyre, por nuk

është e pamundur t'i mposhtni ata. Ne duhet t'i përgëzojmë për mënyrën se si ata punuan ose luajtën, por kjo është shtëpia jonë. Ne duhej të vraponim, të luftonim, të ishim efikas dhe

të shënonim gola. Jam i lumtur për Gabin që hyri dhe shënoi. Kjo tregon se sa e fortë është skuadra jonë. Nuk është e lehtë të luash tri ndeshje në një javë. E bëra këtë. Mendoj se jam rikthyer

me gjendjen time fizike. Kam luftuar, vrapuar dhe ndihmuar ekipin. Por, siç thotë Gabi, i gjithë ekipi luajti në mënyrë mahnitëse dhe ne fituam ndeshjen", ka thënë Jesus.

SHKURT

Mumini do të gjykojë në ndeshjen Melikgazi Kayseri - Olympiacos

Gjyqtari i njohur nga Kosova, Xhelal Mumini, është deleguar për të gjykuar në ndeshjen e grupeve të FIBA EuroCup Women. Mumini do të gjykojë në sfidën në Turqi, Melikgazi Kayseri-Olympiacos. Ky takim do të zhvillohet më 11 tetor nga ora 18:30 në Kayseri të Turqisë. Mumini është një nga katër gjyqtarët e Kosovës të licencuar nga FIBA, ndërsa për periudhën 2023-2025 janë edhe Ngadhnjim Shabani, Elldin Uglari dhe Amar Djeković, si dhe për FIBA komisionar Faton Kurshumlja.

Guardiola: Messi është më i miri që kam parë ndonjëherë

Trajneri Pep Guardiola edhe një herë e ka shprehur admirimin që ka për yllin argjentinas të futbollit Lionel Messi. Tekniku spanjoll ka ritheksuar se për të, "pleshti", 7 herë fitues i "Topit të Artë", është më i miri i të gjitha kohëve. "Ai është më i miri që kam parë ndonjëherë. E kam parë Maradonën, por e kam parë edhe Messin. Maradona ishte sigurisht më i miri në kohën e tij. Më vjen keq për të gjithë të tjerët, por Messi është diçka tjetër", u shpreh teknik spanjoll.

Reali merr vendim për të ardhmen e Kroosit

Mesfushori gjerman Toni Kroos është futur në vitin e fundit të kontratës me Real Madridin. Bordi i Realit tashmë i ka ofruar Kroosit mundësinë për ta zgatur qëndrimin e tij në "Santiago Bernabeu" edhe për një vit. 33-vjeçari nuk e ka ndërmend të transferohet në ndonjë skuadër tjetër, por është duke e shqyrtuar opsionin e rinovimit ose atë të pensionimit nga futbollit aktiv. Kroosi në vitin 2014 u transferua nga Bayern Munchen dhe që nga ajo kohë është shndërruar ndër shtyllat më të forta të klubit spanjoll, me të cilin ka luajtur 282 ndeshje për Realin dhe ka shënuar 22 gola.

Holanda e 'plagosur' për ndeshjet ndaj Francës dhe Greqisë

Teun Koopmeiners nuk do të luajë në ndeshjet e radhës që Holanda do të zhvillojë kundër Francës dhe Greqisë, të vlefshme për kualifikueset për Kampionatin e ardhshëm Evropian. Mesfushori i Atalantas filloi stërvitjen me përfaqësuesen edhe pse i lënduar, e për këtë arsye trajneri Ronald Koeman ka vendosur që të mos rrezikojë me të. "Tulipanët" kanë mjaft probleme me lëndimet, pasi jashtë kanë mbetur portierët Mark Flekken dhe Justin Bijlow, si dhe mbrojtësit Jurrien Timber, Matthijs de Ligt, Sven Botman dhe Tyrell Malacia. Listës së lojtarëve të padisponueshëm i janë shtuar Noa Lang, Memphis Depay, Cody Gako, Frenkie de Jong dhe Steven Berghuis.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria -VI ada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSLOVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:1086/1
 Datë: 10.10.2023

SHPALLJE KONKURSI

Për regjistrimin e kandidatëve të gjeneratës së dytë për nivelin e 5-të, të kualifikimit “Këshilltarë për Karrierë” në Qendrën e Kompetencës – Prizren

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e kandidatëve për regjistrimin e kandidatëve për nivelin 5 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), në Qendrën e Kompetencës në Prizren,

Të drejtë aplikimi kanë:

- 1.1 Kandidatët, Individë që punojnë në sektorin e arsimit dhe punësimit publik dhe privat (mësimdhënës, stafi i qendrave për karrierë, këshilltarët në zryet e punësimit, kompanitë e rekrutimit, ofruesit e trajnimeve);
- 1.2 Kandidatët të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë, shkollimin universitar (niveli 4 i kualifikimit ose më lartë).
- 1.3 Kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin, barasvlerësimin e diplomave dhe dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Ofrimi i kualifikimit

Baza e ofrimit të kualifikimit është Qendra e Kompetencës në Prizren si Institucion i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK)

3. Përfitimet për kandidatët

Të gjithë kandidatët të cilët me sukses e përfundojnë këtë kualifikim, do të pajisen me certifikatë të nivelit V për “Këshilltarë në karrierë” sipas standardeve të AKK

4. Kreditë

Kualifikimi për “Këshilltarë në karrierë” zgjat një 240 orë mësimore – gjashtë javë trajnimi, ku sipas KKK Kualifikimi Kombëtar Profesional (D) me 12 Kredi të Arsimit dhe Aftësimi Profesional.

5. Pagesa për kualifikim

Sigurimi i cilësisë së kualifikimit bëhet nga AKK dhe AAAPARr. Të gjithë kandidatët të cilët pranohen për këtë kualifikim janë të obliguar që në afat prej 5 ditëve pasi të fillojnë ligjëratat, të paguajnë shumën prej 420 (katër qind e njëzet) Euro.

6. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Kandidatët për të konkuruar për regjistrim në kualifikimin e nivelit 5, “Këshilltarë në karrierë” duhet të paraqesin këto dokumente:

- ✓ Aplikacionin e cila merret Qendrën e Kompetencës Prizren;
- ✓ Kopja e letërnjoftimit
- ✓ Diplomën e shkollimit të mesëm të lartë,
- ✓ Diplomë tjetër të shkollimit universitar,
- ✓ CV
- ✓ I gjithë dokumentacioni duhet të prezantohet si kopje ndërsa origjinalet për verifikim i sjellin vetëm kandidatët të cilët do të pranohen.

7. Afati i paraqitjes së dokumenteve, vendi dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve bëhet prej datës 09.10.2023 deri 18.10.2023.

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Qendrën e Kompetencës Prizren, Lagjja Dardania pn, 20000 Prizren.

Lista e kandidatëve të pranuar shpallet më 24 tetor 2023

Pagesat bëhet në afat prej 7 ditëve pasi të shpallet lista.

Kthimi i dokumenteve për kandidatët, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet pas shpalljes së rezultateve.

Kandidatët e refuzuar në bazë të kriterëve për regjistrim kanë të drejtë që brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve të paraqesin ankesë në Qendrën e Kompetencës Prizren

8. Kriteret e regjistrimit

Përparësi kanë kandidatët, Individë që punojnë në sektorin e arsimit dhe punësimit publik dhe privat (mësimdhënës, stafi i qendrave për karrierë, këshilltarët në zryet e punësimit, kompanitë e rekrutimit, ofruesit e trajnimeve);

9. Kuotat për pranim të kandidatëve

Do të pranohen gjithsejt 15 kandidat për grup.

10. Fillimi i trajnimit

Pjesa e pare e trajnimit fillon 06.11.2023-17.11.2023

Pjesa e dytë e trajnimit fillon 27.11.2023-08.12.2023

Pjesa e tretë e trajnimit fillon 18.12.2023-29.12.2023

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Akademia Ora” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 810850091.

Egzona Rrustemi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë (X), njëmbëdhjetë (XI) dymbëdhjetë (XII) si dhe Diplomën e Gjimnazit “Naim Frashëri” Shtime.

AGRON PEÇI, shpall te pavlefshme dëftesën 1-8 SHFMU “MUHARREM BEKTESHI”.

KENAN JONUZI, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme te larte “ARKITEKT SINANI”.

BEKIM PEÇI, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore “ISMAIL QEMALI”.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940

